

VENDIM
Nr.365, datë 1.4.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM
TË KOMUNËS SINABALLAJ TË QARKUT TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të komunës Sinaballaj të qarkut të Tiranës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ të komunës Sinaballaj të qarkut të Tiranës, miratuar me vendimin nr.101, datë 3.2.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Sinaballaj të qarkut të Tiranës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Sinaballaj për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

NUMRAT RENDORË TË PRONAVE NË LISTËN E INVENTARIT	FUSHA E PËRDORIMIT TË PRONËS	LLOJI I TRANSFERIMIT
1-7	PRONA QË PËRDOREN PËR REALIZIMIN E PROGRAMEVE ARSIMORE.	NË PRONËSI
8-10	PRONA QË PËRDOREN PËR REALIZIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E SHËNDETIT PUBLIK.	NË PRONËSI
11-24	VARREZAT PUBLIKE	NË PRONËSI
25-37	TROJE TË LIRA DHE HAPËSIRA PUBLIKE TË PAZËNA NDËRMJET NDËRTESAVE OSE OBJEKTEVE TË ÇDO LLOJI.	NË PËRDORIM
38-45	PRONA QË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE.	NË PRONËSI
170-171, 174-198	INFRASTRUKTURË (SHESHE LULISHTJE DHE SHËRBIME PUBLIKE), RRUGË VENDORE	NË PRONËSI
201,204	PRONA QË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT (TOKA JOPRODUKTIVE DHE KANALE TË TRETA)	NË PRONËSI
236-256	PRONA QË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT (TOKA PRODUKTIVE)	NË PËRDORIM